



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.212/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Lokale, të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.A.nr.212/2025, e datës 14.10.2025, e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Lokale, të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Më 12.10.2025 rreth orës 11:00, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik (LDK) për tu zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, z. Gëzim Mehmeti në rrjetin social ka postuar (reklama aktive) foto dhe video me përshkrimin: "113 LDK Përparim Rama, 16 Gëzim Mehmeti.

Me këtë veprim, kandidati dhe subjekti politik i lartcekur, kanë shkelur dispozitat e nenit 37 parag .1 pikal.2 i LZP-së Bërja e fushatës në ditën e heshtjes zgjedhore' Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kukojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë në ankesë ka bashkangjitur foto të postimit në rrjete sociale.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LDK, thekson se postimi i përmendur është pjesë e një plani komunikimi njëmuor dhe nuk është krijuar, përgatitur apo inicuar në ditën e zgjedhjeve. Ky plan është bërë publik paraprakisht dhe postimet janë përgatitur me kohë, duke u planifikuar për publikim automatik sipas kalendarit mediatik të subjektit politik Prandaj, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje apo veprim të qëllimshëm nga ana e kandidatit në ditën e zgjedhjeve.

Më tej në përgjigje theksohet se ligji ndalon bërjen e fushatës në ditën e heshtjes zgjedhore, por nuk ndalon postime të planifikuara paraprakisht, e të cilat dalin çdo ditë sipas marrëveshjes dhe nuk behën që në ditën e zgjedhjeve të publikohen, sepse logjikisht fushata është një lloj kampanje për të cilën punohet 30 dite dhe nuk punohet që vetëm ditën e zgjedhjeve të publikohen. Dispozita ligjore ka për synim ndalimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta, të reja, që synojnë të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve atë ditë. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për një veprim aktiv, por për një publikim të paracaktuar, i cili nuk mund të konsiderohet si fushatë e re në ditën e heshtjes.

Sipas përgjigjes së subjektit politik LDK, pala ankuese nuk ka ofruar prova se postimi është bërë konkretisht më 12.10.2025 apo që ka qenë një veprim i qëllimshëm për të ndikuar tek votuesit. Një foto apo postim i shpërndarë në rrjetet sociale nuk përbën dëshmi të mjaftueshme për të provuar një shkelje, përderisa mungon verifikimi i kohës së publikimit origjinal. Postimi në fjalë nuk përmban as thirrje të drejtpërdrejtë për të votuar në ditën e zgjedhjeve, as aktivitete të reja elektorale. Ai është një informim i përgjithshëm, i përgatitur më herët i cili nuk mund të barazohet me fushatë të ditës së zgjedhjeve.

Andaj, kërkojnë që PZAP, duke u mbështetur në provat dhe faktet reale mbi datën dhe rrethanat e krijimit të videos, të konstatojë se nuk ka pasur shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ta hedhë poshtë ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Gëzim Mehmeti, nga subjekti politik LDK, se i njejtë në rrjetin social facebook ka publikuar foto dhe video me përshkrimin: *"113 LDK Përparim Rama, 16 Gëzim Mehmeti*, nuk ka arritur që të vërtetojë se këto veprime janë ndërmarr ditën e zgjedhjeve nga subjekti politik LDK, kundër të cilit është paraqitur ankesa, dhe për të ardhur në përfundim se është bërë shkelje nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet *"Bërja fushatë në çfarëdo mënyre"* Si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. *shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.*

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pa bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook nuk shihet se Gëzim Mehmeti, nga subjekti politik LDK, ka bërë publikimin, me datë 12 Tetor 2025 në ditën e votimit.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se subjekti politik LDK, ka bërë fushatë në ditën e zgjedhjeve me qëllim të ndikimit te votuesit, nuk është

dëshmuar me prova nga pala ankuese, se subjekti në fjalë i ka publikuar video dhe foto për qëllime elektorale andaj ne prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.212/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.